

20160270713

L I G J
PËR NDRYSHIM TË LIGJIT PËR REVIZION TË INSTRUMENTIT PËR NDIHMË
PARAADERUESE (IPA)

Neni 1

Në Ligjin për revizion të instrumentit për ndihmë paraaderuese (IPA) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 66/10, 43/14 dhe 154/15), në nenin 5 paragrafi (2) pika 4) në alinenë 4 pikëpresja në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhëzën "ose".

Në alinenë 5 pas fjalës "pikë" vihet pikë, e lidhëza "ose" në fund të fjalisë shlyhet.

Alineja 6 shlyhet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".